



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 26.2.2025

Nr: 210

Ora: 14:00

VENDIM

PËR

**SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË PARTISË POLITIKE PARTIA “ALEANCA
PËR DEMOKRACI DHE SOLIDARITET”, ME KRYETAR Z. GAQO APOSTOLI,
PËR REGJISTRIMIN SI SUBJEKT ZGJEDHOR PËR ZGJEDHJET PËR
KUVEND TË DATËS 11 MAJ 2025**

Sot më datë 26.2.2025, në seancë publike mora në shqyrtim kërkesën nr. 1298 Prot., datë 25.02.2025, me:

Kërkues: Partia politike “Aleanca për Demokraci dhe Solidaritet”, me kryetar Z. Gaqo Apostoli.

Objekti: Regjistrimi i partisë politike Partia “Aleanca për Demokraci dhe Solidaritet” si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvend të datës 11 Maj 2025.

Baza ligjore: Neni 64, i ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

Në përfundim të shqyrtimit administrativ,

V Ë R E J:

Presidenti i Republikës me Dekretin nr. 399, datë 5.12.2024 ka caktuar datën 11 Maj 2025 për zhvillimin e zgjedhjeve për Kuvend.

Partia “Aleanca për Demokraci dhe Solidaritet”, nëpërmjet Kryetarit, Z. Gaqo Apostoli, ka depozituar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën për t’u regjistruar si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për Kuvend që do të zhvillohen më datë 11 Maj 2025.

Bashkëlidhur kërkesës është paraqitur dokumentacioni vijues:

- a) Vërtetimi i lëshuar nga Zyra e Regjistrimit të Partive Politike, pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, datë 24.02.2025, nëpërmjet të cilit vërtetohet se Partia

Data: 26.2.2025 Nr: 210
Ora: 14:00



“Për shqyrtimin e kërkesës së partisë politike Partia “Aleanca për Demokraci dhe Solidaritet”, me Kryetar Z. Gaqo Apostoli, për regjistrimin si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvend të datës 11 Maj 2025”

“Aleanca për Demokraci dhe Solidaritet”, me iniciale “ADS”, me Kryetar Z. Gaqo Apostoli, rezulton e regjistruar në dokumentacionin e kësaj Zyre.

- b) Deklarata e angazhimit solemn (Model KQZ-04-02).
- c) Deklarata për hapjen e llogarisë së posaçme bankare të partisë politike (Model KQZ-04-03).

Nga dokumentacioni si më sipër dhe nga përmbajtja e kërkesës rezulton se:

- a) Emri zyrtar i partisë është Partia “Aleanca për Demokraci dhe Solidaritet” me shkronja nistore “ADS”, me adresë: Rruga "Grigor Heba", Pll. 45, Ap. 26, Tiranë;
- b) Kryetari i partisë është Z. Gaqo Apostoli, me adresë: Rruga "Grigor Heba", Pll. 45, Ap. 26, Tiranë;
- c) Financieri i partisë është Zj. Merita Çela, me adresë: Rruga "Besim Alla", Pll. Çabej & Pegaso, Ap. 16, Tiranë;
- ç) Personi përgjegjes për komunikim me KQZ-në është Z. Agron Leskoviku, me adresë: Rruga "Brigada e 8", Pll. "Agimi", Shk. 25, Ap. 397, Tiranë;
- d) Specimeni i vulës së partisë është i specifikuar.

Kërkesa e paraqitur nga Partia “Aleanca për Demokraci dhe Solidaritet”, respekton afatin kohor të parashikuar në pikën 1, të nenit 64, të ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

Dokumentacioni bashkëshoqërues i kërkesës, i paraqitur nga Partia “Aleanca për Demokraci dhe Solidaritet” është në përputhje me kriteret e përcaktuara në nenet 64, pika 2 dhe 92/2, pika 2, të ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 19, pikat 1 shkronja “n”, e 2, 64 dhe 92/2, pika 2, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar, si dhe të Udhëzimit nr. 2, datë 22.01.2025, “Për përcaktimin e rregullave për depozitimin dhe verifikimin e dokumentacionit të kandidimit, afatet për publikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit për zgjedhjet për Kuvend të datës 11 Maj 2025.

V E N D O S :

1. Regjistrimin e partisë politike Partia “Aleanca për Demokraci dhe Solidaritet”, me kryetar Z. Gaqo Apostoli, me shkronjat nistore “ADS”, si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvend të datës 11 Maj 2025.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI